



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

VENDIM
Nr. 50, datë 11.12.2020

**PËR LEJIMIN E KANDIDIMIT TË ZOTIT PËRPARIM KALO NË VENDIN
VAKANT PËR GJYQATAR NË GJYKATËN KUSHTETUESE, SHPALLUR NGA
PRESIDENTI I REPUBLIKËS NË DATËN 07.02.2018, RISHPALLUR NË DATËN
27.09.2019 DHE RISHPALLUR NË DATËN 24.09.2020**

Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, i përbërë nga :

Vitore Tusha	- Zëvendëskryetare/Relatore
Fiona Papajorgji	- Anëtare
Arta Marku	- Anëtare
Miranda Andoni	- Anëtare
Saida Dollani	- Anëtare
Ludovik Dodaj	- Anëtar

Asistuar nga sekretare **Vilma Dokushi**,

Me praninë e **Avokates së Popullit, zonjës Erinda Ballanca**, në cilësinë vëzhguesit të përhershëm të mbledhjeve dhe veprimtarisë së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi,

Me praninë e përfaqësuesve të autorizuar të subjekteve të ftuara sipas ligjit për pjesëmarrje, në cilësinë e vëzhguesve, në mbledhjen e Këshillit:

- **zotit Bledar Dervishaj**, përfaqësuesit i autorizuar i Presidentit të Republikës,

- **zonjës Mimoza Arbi**, përfaqësuese e autorizuar e Kryetarit të Kuvendit,

në mbledhjen e datës 11.12.2020, mori në shqyrtim çështjen që i përket:

KANDIDATI PËR GJYQATAR

NË GJYKATËN KUSHTETUESE: Zoti Përparim Kalo

OBJEKTI:

Urdhërimi i lejimit të kandidimit të zotit Përparim Kalo në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, rishpallur në datën 27.09.2019 dhe rishpallur në datën 24.09.2020.

KËSHILLI I EMËRIMEVE NË DREJTËSI

Pasi dëgjoi relatimin e anëtares së Këshillit, **zonjës Vitore Tusha**, mendimin e paraqitur nga Avokati i Popullit, zonja Erinda Ballanca, në cilësinë e vëzhgueses së përhershme në mbledhjen dhe veprimtarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit, dhe si bisedoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I. Rrethanat e çështjes

1. Në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 8577/2000), Presidenti i Republikës, në datën 07.02.2018, ka shpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant, vakancë e parakohshme, të krijuar në Gjykatën Kushtetuese për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Besnik Imeraj.

2. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në përfundim të procedurës së verifikimit dhe të vlerësimit, për vakancën e shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, me vendimin nr. 137, datë 21.09.2019, ka vendosur:

- Pezullimin e procedurës së verifikimit të kandidaturave dhe njoftimin e subjektit që e ka vënë në lëvizje, Presidentin e Republikës për të vlerësuar rishpalljen e thirrjes për paraqitjen e kandidaturave për plotësimin e vendit vakant në Gjykatën Kushtetuese, vakancë e parakohshme, të shpallur me dekretin nr. 10723, datë 07.02.2018 nga Presidenti i Republikës.

3. Në zbatim të vendimit nr. 137, datë 21.09.2019 të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe të nenit 125 të Kushtetutës dhe të pikës 1 të nenit 7/b të ligjit nr. 8577/2000, Presidenti i Republikës, në datën 27.09.2019, ka rishpallur hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant, vakancë e parakohshme, të krijuar në Gjykatën Kushtetuese për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Besnik Imeraj.

4. Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Presidenti i Republikës i ka dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi aplikimet e kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000.

5. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, me vendimin nr. 138, datë 22.10.2019, ka vendosur:

- Revokimin e vendimit nr. 137, datë 21.09.2019 dhe vijimin e procedurave të verifikimit dhe vlerësimit të kandidaturave për plotësimin e vakancës së parakohshme të shpallur nga Presidenti i Republikës me Dekretin nr. 11291, datë 27.09.2019.

6. Sipas rezultatit të shortit manual të realizuar në datën 05.04.2019, nga ana e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi në zbatim të nenit 228 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë” (në vijim ligji nr. 115/2016) dhe të pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të aktit nënligjor normativ, Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 2, datë 15.02.2019 “Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”,

si edhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtari i Këshillit, zoti Eriol Roshi. Për shkak të përfundimit të mandatit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi (i përkohshëm) 2019, zhvillimi i procedurave të verifikimit për këtë pozicion vakant i kaluan Këshillit të Emërimeve në Drejtësi 2020, i cili në datën 15.01.2020 zhvilloi shortin manual dhe relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtarja e Këshillit, zonja Arta Marku. Sipas parashikimit të pikës 5/2, shkronja “b”, të vendimit nr. 4, datë 11.3.2019, të ndryshuar, të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, relatorja Arta Marku kontrollon saktësinë dhe plotësinë e veprimeve të kryera dhe konfirmoi veprimet e deritanishme të relatorëve të mëparshëm.

7. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, për arsye të uljes së numrit të kandidatëve nën minimumin e kërkuar nga ligji, konkretisht 3, me vendimin nr. 268, datë 18.09.2020 i është drejtuar Presidentit të Republikës, i cili, në zbatim të nenit 125 të Kushtetutës dhe të nenit 7/b të ligjit nr. 8577/2000, në datën 24.09.2020 ka rishpallur përsëri hapjen e procedurës së aplikimeve për plotësimin e vendit vakant, vakancë e parakohshme, të krijuar në Gjykatën Kushtetuese për shkak të mbarimit përpara kohe të mandatit të gjyqtarit Besnik Imeraj.

8. Në përfundim të procedurës së aplikimeve për shprehjen e interesit për kandidim, Presidenti i Republikës i ka dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi aplikimet e kandidatëve të shoqëruara me dokumentet e paraqitura prej tyre për përmbushjen e kushteve dhe kriterëve ligjore të përcaktuara në nenin 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe ndër të tjerët edhe kandidatin Përparim Kalo.

9. Në zbatim të nenit 228 të ligjit nr. 115/2016 dhe të pikave 5, 27 deri 37 dhe 41 të aktit nënligjor normativ, Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 2, datë 15.02.2019 *“Për procedurën e shortit të caktimit të relatorëve për pozicionet vakante në çdo institucion”*, si edhe të pikës 4 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, në të njëjtën ditë të mbledhjes së zhvilluar në datën 20.10.2020, është realizuar edhe procedura për caktimin me short manual të relatorëve për vendet vakante të krijuara në Gjykatën Kushtetuese.

10. Sipas rezultatit të shortit manual të realizuar nga Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, lidhur me vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, rishpallur në datën 27.09.2019 dhe rishpallur në datën 24.09.2020, relator për ndjekjen e procedurave të verifikimit, vlerësimit, pikëzimit dhe renditjes së kandidaturave, është caktuar anëtarja e Këshillit, zonja Vitore Tusha.

11. Zoti Përparim Kalo, si njëri ndër kandidatët që ka shprehur interesin për vendin vakant të sipërcituar në Gjykatën Kushtetuese, në zbatim të pikës 22 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, është njoftuar me shkrim për tu paraqitur pranë Këshillit për të vijuar me përmbushjen e procedurave të verifikimit të kandidaturës. Njoftimi me shkrim datë 21.10.2020, është kryer në rrugë elektronike në adresën e deklaruar nga vetë kandidati Përparim Kalo, si dhe gjendet i administruar në dosjen e kandidimit.

12. Në datën 23.10.2020, kandidati Përparim Kalo është paraqitur pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe është pajisur me formularët e deklaramit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij. Kryerja e kësaj procedure vërtetohet nga nënshkrimi prej vetë kandidatit të Deklaratës përkatëse, e cila gjendet e administruar në dosjen e kandidimit.

13. Në datën 03.11.2020 kandidati Përparim Kalo ka depozituar në sekretarinë e Këshillit të Emërimeve në Drejtësi formular të deklaramit dhe autorizimet përkatëse për qëllimet e vijimit të procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, të cilat gjenden të administruara në dosjen e kandidimit.

14. Për llogaritjen dhe ndjekjen e zbatimit të afatit të parashikuar në pikën 2 të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 60 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, me shkresën nr. 325 prot., datë 03.11.2020, Këshilli i ka dërguar ILDKPKI-së listën e kandidatëve dhe personave të lidhur me ta që i nënshtrohen procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit sipas Ligjit nr. 8577/2000 dhe Ligjit nr.115/2016.

15. Bashkëlidhur kësaj shkrese drejtuar ILDKPKI-së, ndërmjet të tjerave, është vendosur edhe Deklarata e nënshkruar nga kandidati Përparim Kalo, ku tregohet se është pajisur me formularët e deklaramit dhe autorizimet që duhet të plotësohen për qëllimet e procedurës së verifikimit të kandidaturës së tij, si edhe data e nënshkrimit, nga e cila fillojnë të llogariten afatet e përcaktuara nga ligji për përmbushjen e detyrimeve ligjore të kandidatit për procedurën e verifikimit të kandidaturës. Sipas kësaj Deklarate, rezulton se kandidati Përparim Kalo është paraqitur pranë zyrës së Këshillit të Emërimeve në Drejtësi dhe e ka nënshkruar atë në datën 03.11.2020.

16. ILDKPKI-ja, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, të ligjit nr. 9049, datë 10.04.2003 “Për deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (në vijim ligji nr. 9049/2003) dhe ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005 “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike” (në vijim ligji nr. 9367/2005), me shkresën nr. 2983/9 Prot., datë 19.11.2020, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Përparim Kalo dhe personat e lidhur me të, nr. 304/26 prot., datë 19.11.2020 ku në përfundim të analizës së hollësishme financiare konkludon se:

Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor (kontrata të shitblerjeve të pasurive të paluajtshme, pasurive të luajtshme), kontrata dhurimi të pasurive, etj.

kontratën e blerjes së pasurisë njësi 71.80 m2 në kompleksin Magnet - Libeskid, me nr.pasurie 3/491:8-N11, ndodhur në ZK 8220, volumi 57, faqe 87. Vlera 90.000 euro.

kontratën e blerjes së pasurisë vend parkim 30 m2, me nr.pasurie 3/491-G7, që ndodhet në ZK 8220, volumi 56, faqe 144. Vlera 20.000 euro.

kontratën e blerjes së pasurisë apartament 100 m2 në Virxhinia, (SHBA), blerë bashkërisht me bashkëjetuesen Ardjana Kalo në vitin 2008.

kontratën e shitblerjes së automjetit me targë TR191X0.

Dokumentacion justifikues ligjor për deklaramin e veprave të artit me vlerë 120.000 euro.

kontratë dhurimi për pronësi të kuotave të shoqërisë Gulliver OK, vlera 70.000 euro, Eni Kalo.

kontratë dhurimi për apartament banimi 112 m2 bashkë me mjediset e përbashkëta ndodhur në Pallatet e Lanës, rruga "Reshit Çollaku", Juna Kalo.

Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me të ardhurat dhe dividentin nga aktiviteti privat në Kosovë.

Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me të ardhurat nga qiraja e apartamentit në SHBA.

Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me kreditë e deklaruara, në:

Alpha Bank Albania (zyrë tek Brigata VIII), 1999, Shuma 80.000 USD.

Alpha Bank Albania (blerje Mitsubishi), 2005, Shuma 20.000 euro.

AK-Invest, institucion financiar, për shkollim, TIS 2018. Shuma 20.000 USD.

ABI Bank, 50.000 euro; data e disbursimit 20.2.2006, data e likuidimit 21.1.2011. ABI Bank 10.000 euro; data e disbursimit 24.12.2009, data e likuidimit 22.9.2014.

Janë të paqarta transaksionet debi/kredi në llogaritë bankare të Përparim Kalo, në ISPB dhe Tirana Bank, për të cilat nuk ka të dhëna.

Mungesë dokumentacioni justifikues ligjor lidhur me burimin e krijimit të shumës 100.000 euro nga Hasan Bylyku, dhënë hua kandidatit sipas kontratës nr. 1219 rep. nr. 205 kol, dt. 31.12.2014, konfirmuar nga Alpha Bank.

Bankat konfirmojnë gjendje të llogarive bankare të Përparim Kalo, në shumat 5.550 euro, 4.307.971 lekë dhe 517 USD, ndërsa deklaruar nga kandidati 4.800.054 lekë, 900 USD, 23.000 euro; gjendje të llogarive të Ardjana Kalo, në vlerat 14.785 euro, 527.671 lekë + 319 USD + 32.339 USD (screen shot i paraqitur), ndërsa është deklaruar vlera 220.000 USD.

Është e paqartë pasuria me nr. 110/13+1-39, vol. 57, fq. 164, zk. 3292, e llojit apartament me sipërfaqe 71.6 m2, ndodhur në Selitë, Tiranë, në emër të Eni Kalo, regjistruar në datë 29.5.2017, përfituar me leje legalizimi.

Automjeti deklarohet nga Eni Kalo në vlerën 10.700 euro, ndërsa sipas kontratës së përcjellë nga DPSHTR është 390.000 lekë.

Sipas ekstraktit të QKB, rezulton se Eni Kalo zotëron 8% ose 544.000 lekë, në shoqërinë Kalo & Associates, ndërsa ka deklaruar 19.5% të kuotave me vlerë 200.000 euro.

Sipas ekstraktit të QKB, rezulton se Eni Kalo zotëron 100% të kuotave të shoqërisë Gulliver OK një kapital 100.000 lekë, ndërsa kuotat e deklaruara të dhuruara, në vlerën 70.000 euro.

Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me ligjin nr. 9049, dt. 10.4.2003, "Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë", i ndryshuar, ligjin nr. 9367, dt. 7.4.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, ligjin nr. 115/2016, datë 3.11.2016 "Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë", si dhe Vendimin nr. 4 datë 11.3.2019 të KED, konstatohet se për kandidatin Përparim Kalo:

- Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin,*
- ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;*
- nuk ka kryer fshehje të pasurisë*
- Nuk ka kryer deklarim të rremë*
- Kandidati nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

17. Gjithashtu, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, në zbatim të pikës 4 të nenit 229 dhe 235 të ligjit nr. 115/2016, të shkronjës "e" të pikës 20, 24, shkronjës "b" të pikës 60 e vijues të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 "Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë", edhe Këshilli ka kryer veprimet

verifikuese të kërimit nga subjekte publike dhe private, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatit Përparim Kalo dhe personave të lidhur me të.

18. Për realizimin e veprimeve verifikuese të lidhura me kontrollin e pasurisë së kandidatit Përparim Kalo, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, në datën 04.11.2020, i është drejtuar me kërkesa për informacion dhe ka marrë përgjigjet përkatëse me të dhënat e kërkuara nga secili prej institucioneve publike dhe subjekteve private (të cilat janë administruar në dosjen e kandidimit), si vijon:

- a) Institucioneve bankare: (1) Banka Alpha Albania, (2) Banka Amerikane e Investimeve, (3) Banka Credins, (4) Banka e Bashkuar e Shqipërisë, (5) Banka e Parë e Investimeve, (6) Banka Intesa Sanpaolo, (7) Banka Kombëtare Tregtare, (8) Banka Procredit, (9) Banka Raiffeisen, (10) Banka Societe Generale, (11) Banka Tirana dhe (12) Banka Union.
- b) Institucione financiare të licencuara nga Banka e Shqipërisë: (1) Ak-Invest, (2) Albania Leasing, (3) Capital Invest, (4) Easypay sh.p.k, (5) Final sha, (6) Fondi Besa, (7) Iutecredit Albania, (8) Landeslease, (9) M – Pay sh.p.k, (10) NOA sha, (11) Porsche Leasing, (12) Posta Shqiptare, (13) Raiffeisen Leasing, (14) Tirana Factoring & Lease, (15) Tranzit sha, (16) Union Financiar Tiranë.
- c) Subjekte financiare të licencuar nga AMF: (1) Fondi i Pensionit Vullnetar Credins Pension, (2) Fondi i Investimit Credins Premium, (3) Fondi i Investimit Raiffeisen Invest Euro, (4) Fondi i Investimit Raiffeisen Prestigj, (5) Fondi i Investimit Raiffeisen Vision, (6) Fondi i Investimit WVP Top Invest, (7) Fondi i Pensionit Vullnetar Raiffeisen, (8) Fondi i Pensionit Vullnetar Sigal.
- ç) Institucione të tjera publike si: (1) Agjencia Shtetërore e Kadastrës, (2) DPSHTRR, (3) D.P.Tatimeve, (4) M.Drejtësisë, (5) OSHEE, (6) QKB, (7) UKT.

19. Në përgjigje të kërkesave për informacion të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të gjitha institucionet publike dhe subjektet private të treguara më sipër, kanë dërguar pranë Këshillit përgjigjet përkatëse ku përmbahen të gjitha të dhënat e kërkuara mbi pasuritë e kandidatëve, nëse kanë pasur të tilla për secilin prej tyre, përfshirë edhe kandidatin Përparim Kalo.

20. Këshilli, në datën 19.11.2020, e ka njohur kandidatin me gjetjet në lidhje me pasurinë dhe i ka kërkuar të paraqesë shpjegime me shkrim dhe dokumente mbështetës në zbatim të nenit 229 dhe 235 të ligjit nr. 115/2016, lidhur me konkluzionet e raportit të ILDKPKI-së. Kandidati, në përgjigje të kësaj kërkesë, ka depozituar dokumentacionin përkatës pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi në datën 25.11.2020, i protokolluar me nr. 495 prot. Me e-maillet e datave 27.11.2020, 02.12.2020, 03.12.2020 dhe 04.12.2020 i janë kërkuar kandidatit sqarime shtesë për të cilat ka kthyer përgjigje në datën 27.11.2020 dhe datat 03 dhe 04 dhjetor 2020, duke depozituar dokumentacionin e protokolluar pranë Këshillit me nr. 514 prot, datë 04.12.2020.

21. Me e-mailin e datës 02.12.2020 i janë kërkuar kandidatit sqarime shtesë në lidhje me pyetjet si vijon:

Në shqyrtim të dokumentacionit të administruar nga ana Juaj, ju lutemi jepni sqarime për sa vijon:

1. *Në deklaratën e interesave private është deklaruar nga ana Juaj: Pronësi mbi një apartament me sipërfaqe 58.3 m2 dhe 8.75 m2 bodrum, privatizuar në vitin 1998, sipas ligjit nr. 7652, datë 23.12.1992 "Për privatizimin e banesave shtetërore", me*

kontratën noteriale të shitjes Nr. 14611 Rep. dhe Nr. 2696 Kol, datë 9.9.1996., bashkë me nënën time, Medije Kalo. Pronësi mbi një shtesë përfituar nga bashkimi me pallatin e ri ndërtuar nga Teknoprojekt shpk. Burimi i financimit: Të ardhurat nga veprimtaria private. Vlera 4.429 lekë (vlera e privatizimit e kohës). Zotërimi 50%. Nga dokumentacioni i ASHK, rezulton Akt Kolaudimi i shtatorit të vitit 2006, kërkohen sqarime lidhur me vlerën e shtesës me sip. 66 m2 dhe burimi i krijimit të saj, pasi keni deklaruar vetëm vlerën e apartamentit të përfituar nga privatizimi prej 4.429 lekë.

2. *Në deklaratën e interesave private është deklaruar nga ana Juaj: Automjet Mitsubishi Pajero, prodhim i vitit 2017 targë TR191XO. Burimi i financimit: Kredi nga Intesa Sanpaolo Bank sipas kontratës. Vlera 3.200.000 lekë. Zotërimi 100%. Rezulton të jetë paraqitur certifikata e pronësisë, sipas të cilës figuron se pronësia e automjetit është fituar nga Përparim Kalo në datë 15.03.2018, ndërkohë që akti i paraqitur i përket blerjes së automjetit nga Konsullata e Nderit të Danimarkës, në vitin 2017. Kërkohet nga ana juaj të paraqitet akti i fitimit të pronësisë (në emër të Përparim Kalo) mbi automjetin me targa TR191XO, datë 15.03.2018.*
3. *Në deklaratën e interesave private është deklaruar nga ana Juaj: Kapital në shoqërinë Kalo & Associates, Vlera 8.027.141 lekë, ndërsa sipas ekstraktit historik nga QKB, kapitali rezulton 4.692.000 lekë (pjesë takuese), kapitali i shoqërisë 6.800.000 lekë. Kërkohen sqarime për sa më sipër.*
4. *Nga Intesasanpaolo Bank janë përcjellë nxjerrje llogarie bankare në emër të Përparim Kalo, nga ku rezultojnë transaksionet si vijon:*
 - dt. 27.2.2003, shuma 168.000 USD, kreditim nga Përparim Kalo. ISPB.
 - dt. 27.2.2003, shuma 160.000 USD, pagesë kësti I nga Përparim Kalo në favor të Goumas Investment shpk. ISPB.
 - dt. 13.3.2003, shuma 198.870 USD, kreditim nga Mezuraj shpk. ISPB.
 - dt. 18.3.2003, shuma 51.375 USD, pagesë në favor të Goumas Investment shpk. ISPB.
 - dt. 18.3.2003, shuma 26.000 USD, pagesë në favor të Trema Engeeniering shpk. ISPB.Kërkohen sqarime lidhur me transaksionet e mësipërme në Intesa Sanpaolo Bank gjatë vitit 2003.
5. *Në deklaratën e interesave private është deklaruar nga ana Juaj: Pronë me sipërfaqe 336.7 m2 në Kodrën e Diellit, fituar me kontratë shitblerje nga shoqëria Agi Cons, datë 16.12.2019. Burimi i financimit: Kredi bankare nga Alpha Bank Albania, me bashkëkredimarrës Enkelejd Seitllari. Vlera 200.000 euro. Zotërimi 100%. Sipas kontratës së shitjes nr. 48 kol., datë 16.12.2019, vlera është 200.000 euro ndërsa pagesa sipas bankës është 300.000 euro, kredia është marrë në shumën 298.000 euro. Kërkohen sqarime për sa më sipër.*
6. *Raiffeisen Bank, përcjell nxjerrje llogarie në emër të Eni Kalo, nga ku figuron se është kredituar në vlerën 82.000 euro, dt. 10.10.2017 me përshkrimin "kalim për blerje shtëpie". Kërkohen sqarime për sa më sipër.*

22. Gjithashtu me e-mailin e datës 04.12.2020 i janë kërkuar kandidatit sqarime shtesë në lidhje me pyetjet si vijon:

1. Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor me shkresën e saj nr. 21125/1 prot, datë 13.11.2020 dërguar Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, informon ndër të tjera se: *Përparim Nevruz Kalo ka të regjistruar në DPSHTRR mjetin me targë TR 5265 M, Ardjana Dalip Kalo, ka të regjistruar në DPSHTRR*

mjetin me targë AA 318 GM, Eni Përparim Kalo, ka të regjistruar në DPSHTRR mjetin me targë AA 095 AD.

2. Siç evidentohet nga shkresa e sipërcituar në lidhje me automjetin Mitsubishi Pajero, me targa TR191 XO (i deklaruar në pronësi nga ana juaj), nuk rezulton i regjistruar në pronësinë tuaj.
3. Në sqarimet e dërguara në mënyrë elektronike në adresë të Këshillit në datën 03.12.2020 evidentohet që për këtë pikë të mos jenë cituar dokumentacioni i përfitimit të pronësisë së mjetit dhe të mos i jetë bashkëlidhur këtyre sqarimeve dokumentacioni përkatës, ju lutemi brenda ditës së sotme ora 12.00 të depozitohen në formën e kërkuar nga ligji dokumentacioni që lidhet me pronësinë dhe regjistrimin e këtij automjeti.

23. Në lidhje me këto pyetje kandidati ka paraqitur shpjegimet e tij dhe depozituar dokumentacionin përkatës, protokolluar pranë Këshillit me nr. 514 prot., datë 04.12.2020.

24. Këshilli, me shkresën nr. 517, datë 04.12.2020 i është drejtuar ILDKPKI-së në zbatim të nenit 65 të vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, për shkak të volumit të dokumentacionit të paraqitur nga kandidati në përgjigje të pyetjeve si më sipër, që mund të ndikojnë në saktësinë e konkluzionit, duke i kërkuar kontrollin e këtij dokumentacioni në raport me konkluzionet e përcjella më parë pranë KED, bashkëlidhur kësaj shkrese dokumentacioni përkatës i dorëzuar nga kandidati. Në lidhje me këtë qëndrim është njoftuar edhe kandidati me e-mailin e datës 04.12.2020.

25. Në lidhje me pronësinë e automjetit *Mitsubishi Pajero me targë AA 191 XO*, Këshilli i është drejtuar (*shkresa nr. 520 Prot., datë 09.12.2020*) Drejtorisë së Përgjithshme e Transportit Rrugor, e cila me shkresën nr. 24990/1 Prot., datë 09.12.2020 ka kthyer përgjigje se:

...Automjeti me targë AA 191 XO, i markës Mitsubishi, modeli Pajero, rezulton i regjistruar prej datës 26.04.2019, në emër të shtetasit Përparim Nevruz Kalo.

26. ILDKPKI-ja me shkresën nr.2983/11 prot., datë 09.12.2020 ka përcjellë pranë KED aktin e përfundimit të kontrollit për kandidatin Përparim Kalo nr. 304/27 prot, datë 09.12.2020, sipas të cilit rezulton:

- a) *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin,*
- b) *ka burime të ligjshme financiare ligjor për të justifikuar pasuritë,*
- c) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë,*
- d) *nuk ka kryer deklarim të rremë,*
- e) *kandidati nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

27. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 82 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, me shkresën nr. 326 Prot., datë 03.11.2020, Këshilli ka dërguar në Prokurorinë e Përgjithshme për kompetencë formularin e vetëdeklarimit të plotësuar nga kandidati Përparim Kalo sipas ligjit nr. 138/2015

“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” (në vijim ligji nr. 138/2015).

28. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 1624/376 Prot., datë 17.11.2020, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Përparim Kalo. Bashkëlidhur kësaj shkrese ndodhet Vendimi datë 16.11.2020 “Për miratimin e rezultateve të verifikimit për subjektin Përparim Nevruz (Novruz) Kalo” me të cilin është vendosur:

1. Miratimin e rezultateve të verifikimit, në lidhje me personin Përparim Kalo, kandidat për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, si më poshtë:

i. Rezulton të ketë emrin e babait “Nevruz” dhe emrin e nënës “Mejdije”, ndryshe nga sa ka deklaruar “Novruz” dhe emrin e nënës “Medije”;

ii. Nuk rezulton të jetë i dënuar me vendim të formës së prerë nga ndonjë autoritet gjyqësor shqiptar, për kryerjen e ndonjë vepre penale;

iii. Nuk rezulton të jetë i dënuar me vendim gjyqësor jopërfundimtar nga ndonjë autoritet gjyqësor shqiptar, për ndonjë çështje penale;

iv. Nuk rezulton të ketë qenë i siguruar me masë shtrënguese të sigurisë personale;

Nuk rezulton të ketë qenë ndonjëherë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale;

vi. Nuk rezulton të ketë indicie apo të dhëna a rrethana, fakte të bëra publike apo informacion, me qëllim verifikimi:

- për veprimtari kriminale të kryer jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
- për qenien në hetim ose gjykim nga një autoritet i huaj;
- për urdhër kërkimi ndërkombëtar lidhur me kryerjen e ndonjë vepre penale prej tij;
- dëbime nga territori i ndonjë shteti jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë;
- përdorimin e të dhënave personale/gjeneraliteteve të tjera.

2. Ky vendim mbi rezultatet e verifikimit t'i njoftohen brenda 3 (tre) ditëve Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, i cili si organ kompetent në zbatim të nenit 12 e 13 të Kreut V të Vendimit të Kuvendit nr. 17/2016, duhet të shqyrtojë nëse janë evidentuar të dhëna që përfshihen në sferën e kufizimeve të nenit 2 të ligjit nr. 138/2015 dhe në vijim, të vlerësojë nëse ato janë brenda periudhës së ndalimit të përcaktuar në nenin 4 të po këtij ligji.

29. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit të kandidatit Përparim Kalo, në zbatim të shkronjës “ç” të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikës 84 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”, Këshilli i është drejtuar me kërkesë për ndihmë administrative për përpunimin e informacionit të klasifikuar për qëllimet e verifikimit të integritetit të kandidatëve Drejtorisë së Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (shkresa nr. 327 Prot., datë 03.11.2020) dhe me kërkesë për informacion Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme (shkresa nr. 329 Prot., datë 03.11.2020).

30. Ky verifikim përbën standardin kushtetues dhe ligjor tashmë të vendosur për figurën dhe integritetin e funksionarëve kushtetues të sistemit të drejtësisë, përpara zgjedhjes dhe gjatë ushtrimit të funksionit, pas ndryshimeve të Kushtetutës në vitin 2016, duke pasur parasysh ato të përcaktuara edhe në Nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, si edhe në ligjet e tjera të nxjerra

në pajtim me të, përfshirë Ligjin Nr. 84/2016, pra mbi të njëjtat standarde dhe interpretim të këtij kriteri në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

31. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar pranë Kryeministrisë ka kthyer përgjigje me shkresën nr. 2672 Prot., datë 13.11.2020 sipas të cilës rezulton:

Në përfundim të procedurave të verifikimit nuk disponohen të dhëna/informacione që bien në kundërshtim me kërkesat e pikës 89 germa "a" dhe "c", për integritetin e figurës të z. Përparim Kalo, kandidat për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese.

32. Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme ka dërguar përgjigje, me shkresën nr. 3030/2 prot., datë 12.11.09.2020, nga ku rezulton se, në lidhje me kandidatin Përparim Nevruz (Novruz) Kalo nuk disponohen të dhëna/informacione që bien në kundërshtim me kërkesat ligjore për integritetin e figurës.

33. Gjithashtu, lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, në zbatim të neneve 229 dhe 236 të ligjit nr. 115/2016, të dispozitave të ligjit nr. 45/2015, si edhe në zbatim të pikës 85 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 "*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*", me shkresën Nr. 328 Prot., datë 03.11.2020, Këshilli ka dërguar formularin e aplikimit përkatës të plotësuar sipas ligjit nga kandidati Përparim Kalo për kompetencë dhe shqyrtim Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

34. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën Nr. 1216/4 Prot., datë 17.11.2020, ka dërguar Vendimin nr. 618, datë 16.11.2020 pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi më rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Përparim Kalo, duke ardhur përfundimet se:

a) Për zotin Përparim Nevruz (Novruz) Kalo, nga verifikimet e kryera deri tani nuk figurojnë të ketë materiale në dokumentet të ish- Sigurimit të Shtetit në emër të tyre, sipas nenit 29, pika 2 të ligjit nr.45/2015 "Për të Drejtën e Informimit për Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë".

35. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave "b", "c" dhe "d" të pikës 1, pikës 2 dhe 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 237 dhe 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91/93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 "*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*", Këshilli ka shqyrtuar dokumentacionin përkatës të depozituar nga vetë kandidati Përparim Kalo në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant.

36. Në datën 05.11.2020, Këshilli i ka kërkuar kandidatin të paraqesë jetëshkrimin e tij në formatin e miratuar nga Këshilli në format elektronik, në përgjigje të së cilës në të njëjtën datë kandidati ka dërguar jetëshkrimin përkatës.

37. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja "c" e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit, Këshilli në

datën 04.11.2020 i është drejtuar me kërkesë për informacion partive politike, duke i bashkëlidhur listat e të gjithë kandidatëve për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese. Në përgjigje të këtyre kërkesave, partitë politike kanë dërguar informacione lidhur me ekzistencën ose jo të të dhënave që do të vërtetonin angazhimin në ndonjë pozicion drejtues në parti politike të secilit prej kandidatëve, përfshirë edhe kandidatin Përparim Kalo.

38. Në lidhje me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “b” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati të ketë *mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë*, nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se kandidati Përparim Kalo ka përfunduar studimet e larta në Universitetin e Tiranës në Fakultetin e Shkencave Politike dhe Juridike në periudhën 1984 - 1989, duke u diplomuar si “Jurist”. Në zbatim të ligjit nr. 80/2015 ky lloj arsimimi kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë.

39. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati të ketë *të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike*, nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetimit të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit, ndërmjet të tjerave, rezulton se kandidati Përparim Kalo ka ushtruar veprimtari profesionale si:

- 1994 – 2020 Shërbime ligjore Zyra e avokatisë Kalo & Associates
- 1994 – 1994 Shërbime ligjore në fushën e sigurimeve INSIG Tiranë
- 1991 – 1993 Inspektor për Noterinë dhe Zyrat e Hipotekës Ministria e Drejtësisë
- 1980 – 1990 Mësimdhënie Shërbime ligjore Shkolla Ushtarake Zall Herr

40. Gjithashtu për këtë rast kandidimi, Këshilli vlerësoi t’i drejtohet me kërkesa për informacion disa institucioneve publike dhe subjekte private, pranë të cilave kandidati Përparim Kalo ka ushtruar funksione publike ose veprimtari private profesionale apo ku gjenden të dhëna lidhur me ushtrimin e detyrave dhe veprimtarinë profesionale të kandidatit, si Dhomës Kombëtare të Avokatisë (*shkresa nr. 450 Prot., datë 11.11.2020*).

41. Lidhur me të dhënat e kërkuara, Këshilli ka marrë përgjigje me shkrim nga Dhoma Kombëtare e Avokatisë (*shkresa nr. 308/1 Prot., datë 11.11.2020*).

42. Në përfundim të veprimeve dhe procedurave të kontrollit dhe verifikimit, në zbatim të neneve 235, 236 dhe 237 të ligjit nr. 115/2016, si edhe të pikave 29, 75 dhe 87 të Vendimit nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, anëtar i Këshillit relator i çështjes ka proceduar me përgatitjen e relacionit përkatës mbi gjendjen e faktit dhe të ligjit të zbatueshëm dhe e ka dërguar çështjen për shqyrtim në mbledhjen e Këshillit.

43. Në zbatim të pikës 33 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi Nr. 4 datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, zv/Kryetari ka thirrur mbledhjen e Këshillit duke njoftuar anëtarët për zhvillimin e saj në datën 11.12.2020, ora 13:00, rendin e ditës, si edhe duke i bashkëlidhur njoftimit materialet e çështjes. Në rendin e ditës është përfshirë edhe çështja me objekt urdhërimin e lejimit/ndalimit të kandidimit të zotit Përparim

Kalo, për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, rishpallur në datë 27.09.2019 dhe rishpallur në datë 24.09.2020.

44. Në zbatim të pikës 34 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi Nr. 4 datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, së bashku me relacionin e përgatitur nga relatori, i është njoftuar kandidatit Përparim Kalo.

45. I njëjti njoftim, së bashku me dokumentacionin e përgatitur nga relatori mbi veprimet e kryera gjatë procedurës së verifikimit, si edhe materiale të çështjes, i janë dërguar edhe Avokatit të Popullit.

46. Për zhvillimin e mbledhjes së Këshillit në datën 11.12.2020, ora 13:00, rendin e ditës dhe relacionin e përgatitur janë njoftuar edhe subjektet që sipas ligjit ftohen të marrin pjesë në mbledhjet e Këshillit.

47. Dita dhe koha e zhvillimit të mbledhjes, si edhe rendi i ditës janë njoftuar publikisht edhe në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e caktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

48. Në mbledhjen e Këshillit, pas relatimit të parashtruar nga anëtari relator dhe shpjegimeve mbi pyetjet sqaruese të drejtuara nga anëtarët e Këshillit, Këshilli dëgjoji mendimin e Avokatit të Popullit lidhur me mënyrën e procedimit të ndjekur për verifikimin e kandidatit Përparim Kalo.

49. Avokati i Popullit, në thelb, parashtroi se ishte dakord me procedurën e ndjekur për verifikimin e kandidatit.

II. Vlerësimi i Këshillit të Emërimeve në Drejtësi

50. Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, duke u bazuar në dispozitat ligjore dhe ato nënligjore normative të zbatueshme për çështjen në shqyrtim, si edhe në rrethanat e faktit që rezultojnë në aktet që përmban dosja e kandidatit, vlerëson se duhet të procedojë me vendim për lejimin/ndalimin e kandidimit të kandidatit Përparim Kalo për vendin vakant në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, rishpallur në datën 27.09.2019 dhe rishpallur në datën 24.09.2020.

51. Në pikën 4 dhe 5 të nenit 125 të Kushtetutës, parashikohet se :

“4. Gjyqtarët e Gjykatës Kushtetuese duhet të kenë arsim të lartë juridik, të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike, me një veprimtari të spikatur në fushën e së drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose në sfera të tjera të së drejtës.

5. Gjyqtari nuk duhet të ketë mbajtur funksione politike në administratën publike ose pozicione drejtuese në një parti politike gjatë 10 vjetëve të fundit përpara kandidimit. Kritere të tjera, si dhe procedura për emërimin dhe zgjedhjen e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese rregullohen me ligj.”

52. Në pikën 1 dhe 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 parashikohet se:

“1. Gjyqtari i Gjykatës Kushtetuese mund të zgjidhet shtetasi shqiptar që përmbush këto kushte:

- a) të ketë zotësi të plotë për të vepruar;*
- b) të ketë mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë;*
- c) të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike dhe të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit;*
- ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënuar me burgim për kryerjen e një vepre penale;*
- d) të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi;*
- dh) të ketë kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij, sipas ligjit.*

2. Kandidati që përmbush kushtet e parashikuara në pikën 1 të këtij neni, duhet të plotësojë edhe këto kritere:

- a) të ketë përvojë pune jo më pak se 15 vjet si gjyqtar, prokuror, avokat, profesor ose lektor i së drejtës, jurist i nivelit të lartë në administratën publike;*
- b) të ketë një veprimtari të njohur në fushën e të drejtës kushtetuese, të drejtave të njeriut ose sfera të tjera të së drejtës;*
- c) të jetë vlerësuar për aftësitë profesionale dhe integritetin etik e moral.”.*

53. Në lidhje me kontrollin e pasurisë, në funksion të ushtrimit të kompetencave të tij për verifikimin e plotësimin të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit, për sa i përket kontrollit të pasurisë, në zbatim të pikës 4 të nenit 229 dhe 235 të ligjit nr. 115/2016, të shkronjës “e” të pikës 20, 24, shkronjës “b” të pikës 60 e vijues të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 *“Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë”*, Këshilli ka kryer veprimet verifikuese të kërimit nga subjekte publike dhe private, të të dhënave mbi pasuritë, interesat private dhe detyrimet financiare që ekzistojnë në emër dhe për llogari të kandidatit Përparim Kalo dhe personave të lidhur me të, çka rezulton në mënyrë të detajuar në paragrafët 16 - 26 të vendimit. Në përgjigje të kërkesave për informacion të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi, të gjitha institucionet publike dhe subjektet private kanë dërguar pranë Këshillit përgjigjet përkatëse ku përmbahen të gjitha të dhënat e kërkuara mbi pasuritë e kandidatit Përparim Kalo.

54. Me shkresën nr. 304/26 prot., datë 19.11.2020, ILDKPKI-ja ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Përparim Kalo dhe personat e lidhur me të, në konkluzion të të cilit ka rezultuar se:

- *Deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin,*
- *ka mungesë dokumentacioni ligjor për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë*
- *Nuk ka kryer deklaram të rremë*
- *Kandidati nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

55. Këshilli, në datën 19.11.2020, e ka njohur kandidatin me gjetjet në lidhje me pasurinë dhe i ka kërkuar të paraqesë shpjegime me shkrim dhe dokumente mbështetës në zbatim të nenit

229 dhe 235 të ligjit nr. 115/2016, lidhur me konkluzionet e raportit të ILDKPKI-së. Kandidati, në përgjigje të kësaj kërkesë, ka depozituar dokumentacionin përkatës pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi në datën 25.11.2020, i protokolluar me nr. 495 prot. Me e-maillet e datave 27.11.2020, 02.12.2020, 03.12.2020 dhe 04.12.2020 i janë kërkuar kandidatit sqarime shtesë për të cilat ka kthyer përgjigje në datën 27.11.2020 dhe datat 03 dhe 04 dhjetor 2020, duke depozituar dokumentacionin e protokolluar pranë Këshillit me nr. 514 prot, datë 04.12.2020.

56. Në këto kushte, bazuar në nenin 65 të vendimit nr. 4, datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, duke u nisur nga parashtrimet dhe volumi i dokumentacionit provues të përcjellë nga kandidati, të cilat u konsideruan si rrethana që mund të sjellin ndikim në saktësinë e përfundimeve të raportit të mëparshëm të ILDKPKI-së, Këshilli me shkresën nr. 517, datë 04.12.2020 i është drejtuar ILDKPKI-së, duke i kërkuar kontrollin e këtij dokumentacioni në raport me konkluzionet e përcjella më parë prej saj, duke i bashkëlidhur edhe dokumentacionin përkatës të dorëzuar nga kandidati.

57. Kurse në lidhje me pronësinë e automjetit *Mitsubishi Pajero me targë AA 191 XO*, i deklaruar nga kandidati por që nuk rezultonte sipas përgjigjes së përcjellë nga DPSHTRR-ja, Këshilli me shkresën nr. 520 Prot., datë 09.12.2020 i ka kërkuar informacion sqarues këtij institucioni për këtë mospërputhje, i cili me shkresën nr. 24990/1 Prot., datë 09.12.2020 ka kthyer përgjigje se:

...Automjeti me targë AA 191 XO, i markës Mitsubishi, modeli Pajero, rezulton i regjistruar prej datës 26.04.2019, në emër të shtetasit Përparim Nevruz Kalo.

58. Me shkresën nr.2983/11 prot., datë 09.12.2020, ILDKPKI-ja ka përcjellë pranë KED aktin e përfundimit të kontrollit për kandidatin Përparim Kalo nr. 304/27 prot, datë 09.12.2020, sipas të cilit rezultoi:

- a) *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin,*
- b) *ka burime të ligjshme financiare ligjor për të justifikuar pasuritë,*
- c) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë,*
- d) *nuk ka kryer deklarim të rremë,*
- e) *kandidati nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

59. Sa më sipër, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi e vlerësoi të plotë dhe ezaurues, sipas kërkesave të legjislationit në fuqi, hetimin e thelluar dhe analizat e hollësishme financiare të realizuara nga ILDKPKI-ja, të përcjella me raportin nr. 304/27 prot., datë 09.12.2020, sikurse edhe përfundimet e këtij institucioni mbi kontrollin e pasurisë dhe interesave private të kandidatit Përparim Kalo.

60. Këshilli pasi verifikoi përputhshmërinë e të dhënave të deklaruara nga kandidati Përparim Kalo në *Deklaratën e Pasurisë dhe Interesave Privatë të Kandidatit për Pozicione të Ndryshme në Institucionet e Sistemit të Drejtësisë* dhe në dokumentacionin e paraqitur prej tij, në raport me të dhënat që rezultojnë nga informacionet e dërguara pranë Këshillit nga institucionet publike dhe private të sipërcituara, si dhe mbi bazën e verifikimeve të kryera, vlerëson se nuk ka gjetje që tregojnë të dhëna të padeklaruara apo mospërputhje të tyre me të dhënat e treguara në deklaratimet e bëra nga kandidati Përparim Kalo.

61. Për këto arsye, në zbatim të shkronjës “dh” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000 dhe të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, Këshilli vjen në përfundimin se kandidati Përparim Kalo ka *“kaluar me sukses procesin e kontrollit dhe verifikimit të pasurisë së tij personale dhe të familjarëve të tij”*. Për rrjedhojë, në zbatim të nenit 235 të ligjit nr. 115/2016, ky kandidat nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit për sa i përket verifikimit të pasurisë.

62. Lidhur me verifikimin dhe kontrollin e integritetit, kandidati Përparim Kalo ka dorëzuar në afat formularin e vetëdeklarimit sipas ligjit nr. 138/2015 *“Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”*, të cilin, Këshilli ia ka përcjellë për verifikim dhe kompetencë sipas ligjit Prokurorisë së Përgjithshme.

63. Prokuroria e Përgjithshme, me shkresën nr. 1624/376 Prot., datë 17.11.2020, ka dërguar pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Përparim Kalo. Bashkëlidhur kësaj shkrese ndodhet Vendimi datë 16.11.2020 *“Për miratimin e rezultateve të verifikimit për subjektin Përparim Nevruz (Novruz) Kalo”*.

64. Prandaj, nisur nga rezultatet e kontrollit të ushtruar nga Prokuroria e Përgjithshme sipas ligjit, Këshilli vjen në përfundimin se kandidati Përparim Kalo, krahas plotësimit të saktë të formularit të vetëdeklarimit, përmbush kushtin e parashikuar nga shkronja “ç” e nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati *“ç) të mos jetë në procedim penal dhe të mos jetë dënues me burgim për kryerjen e një veprë penale;”*.

65. Në vijim të procedurave të verifikimit të integritetit, kandidati Përparim Kalo ka dorëzuar në afat formularin e aplikimit *“Për informim përpara emërimit/zgjedhjes në poste të larta”* parashikuar në ligjin nr. 45/2015 *“Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”* (në vijim ligji nr. 45/2015), të cilin Këshilli ia ka përcjellë për verifikim dhe kompetencë sipas ligjit Autoritetit për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit.

66. Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, me shkresën nr. 1216/4 Prot., datë 17.11.2020, ka dërguar Vendimin nr. 618, datë 16.11.2020 pranë Këshillit të Emërimeve në Drejtësi më rezultatet e kontrollit të ushtruar për kandidatin Përparim Kalo.

67. Prandaj, nisur nga rezultatet e kontrollit të ushtruar nga Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit, Këshilli vjen në përfundimin se kandidati Përparim Kalo, krahas plotësimit të saktë të formularit përkatës të aplikimit, përmbush kushtet e parashikuara nga ligji nr. 45/2015 për pastërtinë e figurës së funksionarit kushtetues në lidhje me sjelljen dhe veprimtarinë tij përpara muajit korrik 1991.

68. Gjithashtu, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi verifikoi, nëpërmjet informacionit të sjellë sipas ligjit nga organe kompetente ligjzbatuese si Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar dhe Shërbimi i Kontrollit të Çështjeve të Brendshme dhe Ankesave pranë Ministrisë së Brendshme, nëse kandidati Përparim Kalo *“ka lidhje ose kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar”*. Ky verifikim përbën standardin kushtetues dhe ligjor tashmë të vendosur për figurën dhe integritetin e funksionarëve kushtetues të sistemit të drejtësisë, përpara zgjedhjes dhe gjatë ushtrimit të funksionit, pas ndryshimeve të Kushtetutës në vitin 2016, duke pasur parasysh ato të përcaktuara edhe në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës, si edhe në ligjet e tjera të nxjerra në pajtim me të, përfshirë ligjin nr. 84/2016, pra mbi të njëjtat

standarde dhe interpretim të këtij kriteri në procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve.

69. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar pranë Kryeministrisë dhe Shërbimi për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat pranë Ministrisë së Brendshme kanë kthyer përgjigje, respektivisht me shkresat nr. 2672 Prot., datë 13.11.2020 dhe nr. 3030/2 prot., datë 12.11.09.2020, nga ku rezulton se, në lidhje me kandidatin Përparim Nevruz (Novruz) Kalo nuk disponohen të dhëna/informacione që bien në kundërshtim me kërkesat ligjore për integritetin e figurës.

70. Për sa më sipër, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi, vjen në përfundimin se në lidhje me kriterin e integritetit të figurës, në zbatim të nenit 236 të ligjit nr. 115/2016, kandidati Përparim Kalo nuk gjendet në kushtet që mund të sjellin ndalimin e kandidimit.

71. Për verifikimin e kushteve dhe kriterëve të tjera ligjore të kandidimit, në zbatim të shkronjave “b”, “c” dhe “d” të pikës 1, pikës 2 dhe 3 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, të nenit 237 dhe 240 të ligjit nr. 115/2016, si edhe në zbatim të pikave 91-93 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli shqyrtoi dokumentacionin e depozituar nga vetë kandidati Përparim Kalo në momentin e kandidimit pranë organit të emërtesës që ka shpallur vendin vakant, shpjegimet dhe dokumentet shtesë të paraqitura nga kandidati mbi kërkesën e Këshillit, si edhe përgjigjet nga informacionet e kërkuara nga institucionet publike dhe subjektet private ku kandidati ka ushtruar funksione publike ose veprimtari private profesionale apo ku gjenden të dhëna lidhur me ushtrimin e detyrave dhe veprimtarinë profesionale të tij.

72. Në lidhje me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “b” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati të ketë *mbaruar arsimin e lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë*, nga dokumentacioni i shqyrtuar rezulton se kandidati Përparim Kalo ka përfunduar studimet e larta në Universitetin e Tiranës në Fakultetin e Shkencave Politike dhe Juridike në periudhën 1984 - 1989, duke u diplomuar si “Jurist”. Në zbatim të Ligjit Nr. 80/2015 ky lloj arsimimi kualifikohet si arsim i lartë juridik, Diplomë e Nivelit të Dytë. Për rrjedhojë, kandidati Përparim Kalo nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.

73. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati të ketë *të paktën 15 vjet përvojë pune si gjyqtarë, prokurorë, avokatë, profesorë ose lektorë të së drejtës, nëpunës të nivelit të lartë në administratën publike*, nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit, ndërmjet të tjerave, rezulton se kandidati Përparim Kalo ka ushtruar veprimtari profesionale si:

- 1994 – 2020 Shërbime ligjore Zyra e avokatisë Kalo & Associates
- 1994 – 1994 Shërbime ligjore në fushën e sigurimeve INSIG Tiranë
- 1991 – 1993 Inspektor për Noterinë dhe Zyrat e Hipotekës Ministria e Drejtësisë
- 1980 – 1990 Mësimdhënie Shërbime ligjore Shkolla Ushtarake Zall Herr

74. Bazuar në gjetjet e cituara në pikën më sipër, Këshilli konstaton se kandidati Përparim Kalo ka ushtruar së paku për 15 vjet veprimtari profesionale nga ato të parashikuara si kusht

për lejimin e kandidimit nga pika 4 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “a” e pikës 2 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000.

75. Për sa i përket kushtit të kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati *të mos ketë ushtruar funksione politike në administratën publike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit*, sikurse parashtrohet në pikën më sipër, si edhe nga jetëshkrimi dhe aktet e administruara në dosjen e kandidimit për veprimtaritë e tjera të ushtruara, Këshilli konstaton se kandidati Përparim Kalo nuk ka ushtruar funksione politike në administratën publike (gjatë 10 viteve të fundit të kandidimit). Për rrjedhojë, kandidati Përparim Kalo nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.

76. Lidhur me kushtin e kandidimit të parashikuar nga pika 5 e nenit 125 të Kushtetutës dhe shkronja “c” e pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, pra që kandidati *të mos ketë mbajtur pozicione drejtuese në parti politike gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit*, nga shqyrtimi i jetëshkrimit dhe të dhënave që rezultojnë nga aktet e administruara në dosjen e kandidimit, sikurse janë korrespondenca me partitë politike, Këshilli konstaton se kandidati Përparim Kalo nuk ka mbajtur pozicione drejtuese në parti politike (gjatë 10 viteve të fundit nga data e kandidimit). Për rrjedhojë, kandidati Përparim Kalo nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas dispozitave të sipërcituara.

77. Në lidhje me kushtin e kandidimit të parashikuar në shkronjën “d” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, që kandidati *të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi*, nga shkresa nr. 308/1 Prot., datë 11.11.2020 e Dhomës së Avokatisë së Shqipërisë rezulton se kandidati z.Përparim Kalo, është mbajtës i licencës së avokatisë nr. 696 dhe ka ushtruar profesionin e avokatit prej vitit 2004 e në vazhdim, anëtar i dhomës vendore Tiranë. Nuk ka detyrime financiare dhe nuk ka masa disiplinore as procedim disiplinor në proces.

78. Në lidhje me kushtin e kandidimit të parashikuar në shkronjën “d” të pikës 1 të nenit 7/a të ligjit nr. 8577/2000, që kandidati *të mos jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore dhe të mos ketë masë disiplinore në fuqi*, nga dokumentacioni i shqyrtuar, përfshirë jetëshkrimin, librezën e punës, shkresa e vërtetime të lëshuara nga organet kompetente të emërtesës etj., që janë të administruara në dosjen e kandidimit, Këshilli konstaton se kandidati Përparim Kalo nuk rezulton të jetë larguar nga detyra për shkaqe disiplinore. Po kështu, nuk rezulton që kandidati të ketë masa disiplinore në fuqi. Për rrjedhojë, kandidati Përparim Kalo nuk gjendet në kushtet e ndalimit të kandidimit sipas kësaj dispozite.

79. Nisur nga sa analizohet dhe arsyetohet më sipër, bazuar në gjetjet dhe të dhënat e konstatuara gjatë procedurës së verifikimit që rezultojnë nga aktet dhe dokumentacionin që përmban dosja e kandidimit, në interpretim dhe zbatim të ligjit të zbatueshëm për kushtet dhe kriteret e kandidimit për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi vjen në përfundimin se duhet të vendoset lejimi i kandidimit të kandidatit Përparim Kalo, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, rishpallur në datën 27.09.2019 dhe rishpallur në datën 24.09.2020.

PËR KËTO ARSYE:

Në mbështetje të nenit 125, pikës 1 të nenit 149/d të Kushtetutës, të nenit 7/a dhe 7/b të ligjit nr. 8577, datë 10.02.2000 “ *Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë*”, të pikës 3 të nenit 229, pikës 4 të nenit 235, pikës 5 të nenit 236 dhe pikës 3 të nenit 237 të ligjit nr. 115/2016 “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, si edhe të shkronjës “a” të pikës 50 të Vendimit të Këshillit të Emërimeve në Drejtësi nr. 4, datë 11.03.2019 “*Për procedurën e verifikimit të kandidatëve për pozicionet vakante në Gjykatën Kushtetuese dhe të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë*”, Këshilli i Emërimeve në Drejtësi,

VENDOSI:

1. Lejimin e kandidimit të kandidatit Përparim Kalo, në vendin vakant për gjyqtar në Gjykatën Kushtetuese, të shpallur nga Presidenti i Republikës në datën 07.02.2018, rishpallur në datën 27.09.2019 dhe rishpallur në datën 24.09.2020.
2. Në zbatim të nenit 238 të ligjit nr. 115/2016, ky vendim i njoftohet kandidatit Përparim Kalo.
3. Ky vendim publikohet në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, në pjesën e përcaktuar për Këshillin e Emërimeve në Drejtësi.

ZV/KRYETARE

Vitore TUSHA

